

Komunikatë

Viti shkollor 91/92, në Kosovë fillon të hënën më 2 shtator për të gjithë nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme. Mësimi fillon sipas orarit dhe ndërresave të parapara.

Apelojmë tek të gjithë nxënësit, arsimtarët, prindët që maksimalisht të angazhohen për fillimin e rregulltë të vitit shkollor. Provokimeve të mundshme të policisë serbe apo të kujdoqoftë tjetër t'iu shmangemi.

Në qoftë se pengohet procesi mësimor ose nxënësve dhe arsimtarëve iu ndalohet hyrja në objektet shkollore atëherë nxënësit dhe arsimtarët të kthehen në shtëpi duke iu shmangur çdo provokimi apo ekcesi të imponuar.

Për vazhdimin e mësimin më 3 shtator e tutje do të vendosë Qeveria e Republikës së Kosovës dhe asociacionet tjera legjitime të Kosovës.

Njoftimi për këtë do të bëhet në konferencën e shtypit më 2 shtator në ora 14 në lokalet e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës.

Grupi punues për çështje të arsimit